



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:096879  
Datë: 28.05.2024  
Numri i dokumentit: 05746656

C.nr.2384/23

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm** gjyqtari Shaban Shala, me pjesëmarrjen e sekretares juridike F.B. në kontestin e paditësit S.D. nga fshati ..... Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.A.H. nga Prizreni kundër të paditurës ..... Sh.p.k me seli në Prizren, cilën e përfaqëson av.B.M. nga Gjakova me objekt të padisë kthimin e borgjit, vlera e kontestit 95,729.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve, më datën **30.04.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit **S.D.** nga fshati ..... Komuna e Rahovecit, ashtu që **DETYROHET** e paditura kompania ..... Sh.p.k, me seli në Prizren, me drejtor-menaxher Sh.G. që paditësit në emër të borgjit tia paguaj (kthej) shumën prej 95,729.00 ( nëndëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzetë e nënd euro) €, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (30.04.2024) deri në pagesën definitive nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

**II. DETYROHET** e paditura që t'ia paguajë paditësit shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 2,280.40 ( dymijë e dyqind e tetëdhjetë euro) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Paditësi S.D. nga fshati ..... Komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.A.H. nga Prizreni, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës ..... Sh.p.k me seli në Prizren, të cilën e përfaqëson av.B.M. me objekt të padisë kthimin e mjeteve (borgjit) me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit ashtu që të detyrohet e paditura tia kthejë borgjin në shumën prej 95,729.00 € me kamatë ligjore.

Në padi dhe gjatë shqyrtimeve të mbajtura i autorizuari i paditësit av. A.H. ka deklaruar se : fillimisht mbetet sikurse në padi, ka rregulluar duke precizuar kërkesë padinë në shumën prej 95.729.00 €, ngase sipas marrëveshjes nuk është dorëzuar banesa e cila është llogaritur në shumën prej 60.000 €. Ka shtuar se është vërtetuar se kërkesë padia është në tërësi

e bazuar ngase lidhur më këtë çështje është lidhur marrëveshja e dt.27.02.2015 për blerjen e aksioneve të kompanisë e cila është nënshkruar nga palët dhe dëshmitar për të cilën marrëveshje është deklaruar dhe vetë përfaqësuesi i të paditurës i cili ka pohuar detyrimin (borgjin) ndaj paditësit dhe se shumën e këtij borgji për shkaqe objektive nuk ka arritur ta kthejë. Në rishqyrtim fillimisht ka mbetur pranë kërkesë padisë ku e paditur është “..... Company”, ku pronar të saj janë I.G., R.G. dhe Sh.G. ku person i autorizuar-Drejtor menaxhues është Sh.G. Ndërsa në fjalën përfundimtare të cilën e ka dorëzuar me shkrim ka deklaruar se gjykata e shkallës së parë në rigjykim ka vepruar në tërësi sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit ku pa mëdyshje është vërtetuar se e paditura tani me Drejtor Menaxhues Sh.G. i ka borgj paditësit shumën prej 95,729.00 euro i cili borgj ka ardhur si rezultat i punës juridike marrëveshjes të dt.27.02.2015 ku e paditura kishte blerë aksionet e paditësit sikurse në padi dhe se nga administrimi i provave është vërtetuar se paditura i ka borgj paditësit shumën e kërkuar në padi sepse ia kishte blerë aksionet në këtë shumë të cilin fakt dhe e ka pohuar e paditura në shqyrtimin kryesor të dt.02.10.2022. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën e përgjithshme prej 2.343,20 €, në kuadër të cilës hyjnë shuma prej 1,532.00 € para kthimit të lëndës në rigjykim dhe shuma prej 811,20 € e cila përfshinë 3 përfaqësime nga 270 €.

I autorizuari i të paditurës av. B.M. gjatë shqyrtimeve të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se ka mbetur në tërësi sikurse në përgjigjen në padi me anë të cilës e ka kundërshtuar në tërësi padinë. Ndërsa në shqyrtimin përgatitor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, pretendimeve në ankesë dhe pranë deklarimeve nga shqyrtimet e mbajtura. Ka shtuar se pasi që i autorizuari i paditësit precizoi kërkesë padinë duke kërkuar nga e paditura tja kthejë borgjin në shumën prej 95,729.00 € me kamatë ligjore nga dita kur ka ra në vonesë e paditura e paditura thekson çështjen e parashkrimit ngase borgji i kërkuar në kuptim të dispozitave ligjore të LMD-së është parashkruar. Ndërsa në fjalën përfundimtare të cilën e ka dorëzuar më shkrim ka deklaruar se pas administrimit të provave konsideron se kërkesë padia e paditësit në tërësi është e pa bazuar nga shkaqet e cekura gjatë shqyrtimeve të mbajtura. I ka kërkuar shpenzimet procedurale në shumën prej 1,080.00 € për 4 përfaqësime gjyqësore nga 270.40 €.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: ka bërë leximin e marrëveshjes të dt.27.02.2015 e lidhur ndërmjet S.D. dhe “..... Company” si dhe ka bërë dëgjimin e palëve ndërgjyqëse dhe pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e **bazuar** nga arsyerat e cekura si më poshtë.

Nga leximi i marrëveshjes të dt.27.02.2015 gjykata vërteton faktin se obligimi i mbetur i të paditurës për paditësin është në shumën prej 102.000 CH (franga zvicerane) konvertuar në euro shuma prej 95.729 €. Në emër të këtij detyrimi e paditura është obliguar që tja jap si kompensim një banesë prej 100 m<sup>2</sup> në katin e parë të banimit në vlerën prej 60.000 € duke llogaritur 1 m<sup>2</sup>=600 €. Ndërsa pjesën tjetër të borgjit në shumën prej 35.729 € e paditura do tja paguaj paditësit në dy këste:20.000 € në muajin mars, ndërsa 15.729 € në muajin korrik 2016.

Nga dëgjimi i paditësit S.D. në cilësinë e palës gjykata vërteton faktet se: se marrëveshja e dt.27.02.2015 është e vërtet dhe se është nënshkruar në zyrën e të paditurës. Kësaj marrëveshje i ka parapri fakti se diku nga viti 2006 paditësi së bashku më vëllain e tij Velinë kanë hyrë si akcionar në këtë kompani duke paguar diku 140.000 € deri në 150.000 €.

Në 2-3 vitet e para gjithçka ka funksionuar mirë ku përpos devidendes (fitimit) është kthyer dhe një pjesë e investimit, mirëpo më vonë kanë filluar të paraqiten problemet, fillimisht duke mos dhënë informacione, ndërsa më pas duke mos kthyer investimet në të holla. Ka shtuar se e paditura asnjëherë nuk ka kundërshtuar borgjin, por mos pagesën e ka arsyetuar më vështirësitë ekonomike. Në fund ka shtuar se as banesa dhe as shuma tjetër e të hollave sipas kësaj marrëveshje nuk është dorëzuar respektivisht paguar nga ana e të paditurës.

Nga dëgjimi i përfaqësuesit të paditurës F.G. në cilësinë e palës gjykata vërteton faktet: se përfaqësuesi i të paditurës nuk e mohon ekzistimin e kësaj kontrate dhe për rrjedhojë i pohon detyrimet nga kjo kontratë, pra detyrimin në shumën prej 95.729 €, ku shuma prej 60.000 € është llogaritur për një banesë në sipërfaqe prej 100 m2 duke llogaritur 1 m2=600 €, ndërsa vlera tjetër e cila ka mbetur për tu paguar në dy këste kap vlerën prej 35.729 € e cila shumë nuk është paguar për shkak të vështirësive financiare. Mirëpo ka propozuar që të vazhdohet sipas marrëveshjes së dt.27.02.2015 ashtu që pas sigurimit të lejes ndërtimore dhe ndërtimit të objektit ti dorëzohet banesa e përcaktuar, e më vonë të paguhet detyrimi i mbetur në të holla.

Nga provat e administruara më lart dhe faktet e vërtetuara gjykata ka konstatuar gjendjen faktike sipas të cilës paditësi me të paditurën me datë 27.02.2015 kanë lidhur marrëveshjen (kontratën) sipas të cilës e paditura detyrohet që paditësit në emër të investimit në të holla në kapitalin e kompanisë t'ia kthejë borgjin në shumën prej 95.729 € duke i dorëzuar fillimisht banesën në sipërfaqe prej 100 m2 llogaritur në vlerën prej 60.000 € dhe në dy këste shumë e mbetur prej 35.729 €, nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar faktin se kjo marrëveshje nuk është përmbushur, ashtu që paditësit nga e paditura nuk i është dorëzuar as banesa në vlerën e përcaktuar sikurse më lartë, por as dhe shuma e mbetur e këtij detyrimi në të holla. Se vërtet kjo marrëveshje nuk është përmbushur, pra se e paditura nuk ia ka dorëzuar banesën paditësit dhe as detyrimin e mbetur nga kjo shumë, pra borgjin në shumën prej 35,729 ky fakt vërtetohet dhe nga vetë përfaqësuesi ish përfaqësuesi i të paditurës F.G. i cili ka qenë dhe nënshkrues i marrëveshjes ku me rastin e dëgjimit të tij shprehimisht e pohon një fakt të tillë deklaruar se ky detyrim sipas kësaj marrëveshje ekziston dhe ato nuk janë përmbushur për shkak rrethanave objektive dhe vështirësive ekonomike, pra e paditura nuk ia ka kthyer borgjin në shumën e përcaktuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që e paditura i ka borgj paditësit shumë prej 95,729.00 € të cilën shumë ia ka paguar të paditurës si kapital investues në kompani dhe këtë shumë të borgjit e paditura nuk ia ka kthyer deri më tani, andaj gjykata në kuptim të nenit 245 par.1 LMD-së i cili përcakton se: **“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”**, për shkak se në rastin konkret pala e paditur paditësit i ka borgj shumë e vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi se fare nuk ka zbatuar marrëveshjen e dt.27.02.2015 dhe atë në asnjë mënyrë apo pjesë të saj i cili fakt vërtetohet dhe nga deklarimi i palës së paditur gjatë shqyrtimeve të mbajtura.

Lidhur me kundërshtimin e palës së paditur se pas precizimit të kërkesë padisë nga pala paditëse në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesës gjykata vlerëson se një pretendim i tillë është i pa bazuar ngase nga shkresat e lëndës rrjedh se borgji në këtë kontest rrjedh nga marrëveshja e dt.27.02.2015, ndërsa padia në gjykatë nga pala paditëse është parashtruar më dt.24.08.2016 diku pas një viti e gjysmë, ndërsa në rastin konkret kur të merret për bazë se afati

Numri i lëndës: 2019:096879  
Datë: 28.05.2024  
Numri i dokumentit: 05746656

i përgjithshëm i parashkrimit sipas nenit 352 të LMD-së është 5 vjeçar gjykata vlerëson se në këtë rast nuk kemi parashkrim.

Me rastin e vendosjes në rigjykim gjykata ka marr për bazë të udhëzimet e dhëna sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.1394/20 dt.09.06.2023.korigjohet

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e marrjes së aktgjykimit (30.04.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 452 të LPK-së ngase paditësi e ka fituar kontestin, ndërsa e paditura e ka humbur e të cilat shpenzime përfshijnë : në emër të përpilimit të padisë shumën prej 208 €, për pjesëmarrje në 6 seanca nga 270.40 € shumën prej 1,622.40 €, për dy shqyrtime të shtyra nga 135.20 € dhe taksën gjyqësore në shumën prej 180 €, gjithsejtë shumën prej 2,280.00 €, bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga arsyet e cekura si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**C.nr.2384/23, datë 30.04.2024**

**Sekretare juridike,**  
**Feriha Brando**

**Gjyqtari,**  
**Shaban Shala**

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesë në afat prej 15 ditësh, pas marrjes të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.